

28.05.2018,

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ARENI 2018" sh.p.k**

EMERTIMI – FORMA – OBJEKTI – KOHEZGJATJA

**NENI 1
EMERTIMI I SHOQERISE**

- (i) Shoqeria themelohet ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar. Emertimi i shoqerise eshte: **"ARENI 2018" sh.p.k** (me poshte e quajtur "Shoqeria");
- (ii) Shoqeria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj prane Regjistrat Tregtar Shqiptar (Q.K.R)
- (iii) Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe me Ligjin Nr. 9901 dt 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Ligji Nr.10475 date 27.10.2011 "Per disa ndryshime ne Ligjin 9901 date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe ne dispozitat e parashikuara nga **Statuti dhe Akti i Themelimit** te saj.

**NENI 2
SELIA E SHOQERISE**

- (i) Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: **Tirane, Qesara, Rruga e Dajtit nr, pasurie 199/32-G1**
- (ii) Shoqeria mund te hape filiale, dege apo zyra perfaqesimi ne qytete te tjera te Republikes se Shqiperise dhe/ose jashte saj, me vendim **te Asamblese se Ortakeve**.

**NENI 3
OBJEKTI I SHOQERISE**

Shoqeria ka per objekt; Tregtine me shumice dhe Pakice te mallrave industriale dhe bujqesore. Import – Eksport, si dhe cdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te Shoqerise e qe nuk bie ndesh me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

**NENI 4
KOHEZGJATJA**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje afat kohor te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit te saj prane Regjistrat Tregtar Shqiptar. Vendimi per prishjen e Shoqerise merret nga Asambleja e Ortakeve

E.P.

KAPITALI

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

- (i) **Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 1.000.000 Leke (Nje milion leke) Kapitali themeltar i Shoqerise eshte teresisht i nenshkruar dhe i derdhur perkatesisht nga ortaket:**
 - **z.Egzon PECAKU me kontribut 1.000.000 Leke(Nje milion leke) qe perfaqesojne 100% te kapitalit themeltar te Shoqerise;**
- (ii) Pjeset e kapitalit themeltar te Shoqerise jane lirisht te transferueshme sipas Ligjit Shqiptar ne fuqi;
- (iii) Ortaket e Shoqerise pergjigjen per detyrimet kundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te saj.

NENI 6

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

- (i) Asambleja e Ortakeve, ligjërish e thirrur dhe rregullisht e mbledhur, perfaqeson unanimitetin e ortakeve dhe eshte organi me i larte **Vendim-Marres i Shoqerise**. Vendimet e saj te marra ne përputhje me Legjislacionin ne fuqi dhe dispozitave te këtij **Akti Themelimi dhe Statutit** jane te detyrueshme per te gjithë Ortaket qofshin te pranishem ose jo, ne favor ose kundra;
- (ii) Asambleja e zakonshme duhet te mblidhet te pakten nje here ne vit brenda gjashte muajve nga mbyllja e vitit financiar te Shoqerise;
- (iii) Data, vendi dhe rendi i dites se mbledhjes se Asamblese se Ortakeve i komunikohen ortakeve nepermjet letres rekomande, te pakten 5 dite përpara;
- (iv) Asambleja e Ortakeve thirret nga Adminsitratori i Vetem ose nga nje a me shume Ortake qe perfaqesojne te pakten 5% te kapitalit te Shoqerise;
- (v) Vendimet e Asamblese se Ortakeve ne mbledhje te zakonshme te saj jane te vlefshme kur miratohen nga nje a me shume ortake qe perfaqesojne shumicen e kapitalit Themeltar te Shoqerise;
- (vi) Vendimet e Asamblese se Ortakeve ne mbledhje te jashtëzakonshme jane te vlefshme kur miratohen nga nje a me shume ortake qe perfaqesojne te pakten 51% te kapitalit Themeltar te Shoqerise.
- (vii) Asambleja e Ortakeve miraton llogarite dhe Bilancin e Shoqerise te komunikuar nga Administratori ose Ortaket qe perfaqesojne mbi 51 % te kapitalit te Shoqerise brenda gjashte muajve nga mbyllja e vitit financiar dhe vendos lidhur me ndarjen e fitimit ne formen e dividendit.

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 7 ADMINISTRATORI

- (i) Shoqeria administrohet nga Administratori i Vetem, i cili emerohet nga Asambleja e Ortakeve;
- (ii) Administratori i vetem do te qendroje ne detyre deri ne momentin e revokimit te mandatit te tij nga Asambleja e Ortakeve;
- (iii) Administratori mund t'u delegoje personave te trete te caktuar prej tij, nje pjese apo te gjitha kompetencat e tij me miratimin e Asamblese se Ortakeve;
- (iv) Administratori pergjigjet personalisht perballe Shoqerise dhe/ose te treteve per shkelje te Ligjit dhe/ose te Aktit te Themelimit ose Statutit.
- (v) Administratori mund te shkarkohet ne cdo moment me vendim te Asamblese se Ortakeve, te miratuar nga nje apo me shume ortake qe perfaqesojne 51% te kapitalit themeltar te Shoqerise;
- (vi) Gjithashtu, Administratori mund te shkarkohet ne cdo moment me vendim te autoritetit Gjyqësor Shqiptar per shkelje te Ligjit.
- (vii) Administrator i shoqerise emerohet **z.Egzon PECAKU**
- (viii) Administratori **z.Egzon PECAKU** emerohet per nje periudhe 5 (pese) vjecare duke filluar qe nga data e regjistrimit prane **QKR**

VITI FINANCIAR – EKSPERTI KONTABEL – PRISHJA E SHOQERISE

NENI 8 VITI FINANCIAR DHE BILANCI

- (i) Cdo vit financiar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te cdo viti. Me mbylljen e vitit financiar, përgatit bilancin e Shoqerise ne përputhje me dispozitat Ligjore ne fuqi;
- (ii) Përrjashtimisht, viti i pare financiar fillon ne ditën e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe mbyllet me 31 dhjetor.

NENI 9 FITIMI DHE DIVIDENDI

Fitimi qe rezulton nga bilanci i miratuar rregullisht, pasi te jete zbritur vlera e destinuar per rezerven ligjore, dhe stutore dhe te providenteve, mund te mbarten per vitet pasardhëse apo te shpërndahen si dividend ndermjet Ortakeve te Shoqerise ne përputhje me Vendimin e Asamblese se Ortakeve per miratimin e bilancit.

NENI 10
EKSPERTI KONTABEL/FISKAL

Eksperti Kontabël/Fiskal i Shoqërise do të emërohet nga Asambleja e Ortave nëse emërimi i tij është i detyrueshëm në bazë të Legjislacionit në fuqi. Mandati i Ekspertit Kontabel/Fiskal është i rinovueshëm me Vendim të Asamblese së Ortave. Eksperti Kontabël/Fiskal mund të shkarkohet nga detyra me vendim të Asamblese së Ortave për mos kryerjen e detyrës, gabime dhe për mungesë profesionale.

NENI 11
PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Në çdo moment dhe për çdo arsye që mund të çojë në prishjen e Shoqërise, menyrat dhe procedurat për kryerjen e likuidimit dhe emërimin e likuidatorit/likuidatorëve do të vendosen nga Asambleja e Ortave në përputhje me Legjislacionin Shqiptar në fuqi.

NENI 12
NORMA REFERUESE

- (i) Për sa nuk parashikohet në këtë Akt Themelimi bëhet referim në ligjet e Republikës së Shqipërisë në fuqi në fushën e Shoqërive Tregtare;
- (ii) Autoriteti Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë ka kompetencë ekskluzive për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve që mund të lindin midis Ortave, midis këtyre e organeve të Shoqërise ose Shoqërise.

NENI 13

Ky Akt Themelimi i Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar **“ARENI 2018” sh.p.k** përpilohet në 4 (Katër) kopje në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë secila, që nënshkruhen rregullisht nga Ortaket. Shoqëria u themelua sot më dt.28/05/2018.

Ortaket:

z.Egzon PEÇAKU

Egzon Peçaku

E. P.

E. P.